

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Abdullah Ahmeti , anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.E. nga Ferizaji, për shkak të dy veprave penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.2 nën par.2.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim te paautorizuar te armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe asaj të paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit B.E. av. M.M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.220/2017 datë 17.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.12.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit B.E., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.220/2017 datë 17.10.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.220/2017 datë 17.10.2018, të akuzuarin B.E. e ka shpallur fajtorë për shkak të dy veprave penale, ku për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.2 nën par.2.1 të KPRK-së i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 16 muajve dhe për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim te paautorizuar te armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së i është shqiptuar dënim me gjobë ne shume prej 800 euro, te cilët dënime do te ekzekutohen 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrestin shtëpiak nga data 28.09.2014 e deri me dt. 05.02.2015. Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës e zjarrit – revolen e kalibrit 7.65 mm, një karikator, 4 fishekë të njëjtit kalibër. I akuzuari Obligohet qe në emër të viktimave të krimin të paguaj shumën prej 50 euro. Gjithashtu obligohet që të paguaj paushallin gjyqësorë në shumën prej 30 euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë te këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal , me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit B.E. ti shqiptoj dënim me burg efektiv më të rëndë – më të ashpër.

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.E. av. M.M. për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën , aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj në mënyrë që dënimi i shqiptuar me burg të jetë me i butë dhe me gjobë të jetë më i ulët.

-Përgjigje në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore ne Ferizaj ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit B.E. av. M.M., i cili ka propozuar që Gjykata Apelit ta refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit, i akuzuari B.E., mbrojtësi i tij M.M. edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohë dhe vendin e mbajtjes së seancës, kurse prezent ishte i dëmtuari A.H..I dëmtuari mbështeti ankesën e Prokurorisë Themelore.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.505/2018 të dt. 07.11.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore të aprovet , kure përgjigja në ankesën e PTH dhe ankesa e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit B.E. av. M.M. te refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat janë të pa bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore me Ferizaj dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit B.E. av. M.M. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesat janë të pa bazuara. Në ankesën e Prokurorisë dhe mbrojtjes nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Prokuroria në ankesë thekson se gjykata sa i përket të akuzuarit dhe vendimit mbi dënim ka vlerësuar rrethanat përkatëse mirëpo përkundër kësaj ka tejkalar kompetencat ligjore ne matjen dhe përcaktimin e dënimit pasi nuk e ka caktuar drejtë dënimin duke vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese ndërsa edhe pse e ka shpallur fajtores të akuzuarin dhe e ka dënuar me një dënim si ne aktgjykimin e ankimuar as në mënyrë sipërfaqësore nuk ka

përmendur rrethana renduese shkallën e përgjegjesisë penale apo rrezikshmërinë shoqërore dhe nuk ka dhënë peshë të njëjtë rrethanave për matjen e dënimit dhe jo mënyrën e kryerjes së veprës penale. Kurse mbrojtja në ankesë thekson se nga praktikat e me hershme dënimet për lëndime trupore kanë qenë me te buta edhe pse pasojat tek palët kanë qenë më evidente kurse te dënimit me gjobe janë shuma më të buta dhe janë sjell prej 200-400 euro. Nga kjo del se arsyet që janë të ligjshme për vlerësimin e rrethanave renduese dhe lehtësuese nuk janë adekuate. I akuzuari në të gjitha fazat e procedurës ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë, ka pranuar veprimet inkriminuese dhe ka shpreh keqardhje dhe ka kërkuar falje publike, kur kihet parasysh edhe koha kur është kryer vepra penale dhe sjelljen e te akuzuarit nga ajo date e deri me tani bënë më dije se nuk kemi te bëjmë me një recidivist apo person i prirë për kryerjen e veprës penale. Pra gjykata edhe për kundër pranimin të fajësisë gjykata nuk e ka vlerësuar në mënyrë të duhur faktin se çka e ka shtyre të akuzuarin në rastin konkret për të kryer një veprim të tillë kur dihet se në të njëjtin veprim ka edhe të tjerë të cilët janë llogaritur si bashkë kryes.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë, moshën e re të akuzuarit, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese natyrën e lëndimeve të shkaktuara të dëmtuarit A.H. vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjesisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.532/18, më 18.12.2018

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti _____